



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.559/21

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenit 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenit 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Grupit OE “Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit: 616-21-805-1-1-1, të iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Prishtinë, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 22.07.2021 mori këtë:

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e Grupit OE “Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 559/21 e datës 19.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit: 616-21-805-1-1-1, të iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Prishtinë.

- II.** **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Prishtinë që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”.
- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së grupit të operatorëve ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. Grupi i OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 19.07.2021 ka pranuar ankesën me nr. 559/21 nga Grupi i OE “Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë. Ankesa ndërlidhet me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit: 616-21-805-1-1-1, të iniciuar nga AK- Kuvendi Komunal Prishtinë.

AK - Kuvendi Komunal Prishtinë, Njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe Letrën standarde në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit kishte publikuar me datë 02.07.2021.

Kundër vendimit të lartcekur, me datë 08.07.2021 në orën 18:51, Grupi i OE “Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

Me datë 09.07.2021 AK kishte marr vendim me të cilin kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit: 616-21-805-1-1-1 me që fillimisht është vlerësuar se kërkesa është dorëzuar pas afateve ligjore dhe sikur të ishte e afatshme e njëjta do të ishte e pazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga Grupi i OE “Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 559/21 e datës 19.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit: 616-21-805-1-1-1, të iniciuar nga AK- Kuvendi Komunal Prishtinë, dhe vjen në përfundim se e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se OE ankues Kërkesën për rishqyrtim e ka bërë me datë 08.07.2021 në orën 18:51, që do të thotë pas orarit të rregullt të punës, dhe e njëjta llogaritet se është pranuar me datën 09.07.2021. Andaj AK Kuvendi Komunal Prishtinë me të drejtë ka vlerësuar se ankesa e OE ankues konsiderohet të jetë si e jashtë afatshme.

Sipas paragrafit 3 të nenit 108A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave” i cili specifikon:

- a) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.*
- b) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.*
- c) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.*

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga Grupi i OE “Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK-Kuvendi Komunal Prishtinë jashtë afatit ligjor, andaj e njëjta nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi Komunal Prishtinë

1x1 OE -“Rima engineering group 2004 L.L.C. dhe Rima Engineering sh.p.k” me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

